



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

GJUHË E HUAJ D (1)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Semestri i I-rë

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor, Viti i I-rë Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë zotëron më së miri përbmbledhjen e nivelit A1 për zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe jo-gjuhësore të studentit, në mënyrë që ato të plotësojnë nevojat më specifike dhe komplekse të komunikimit. Çdo njësi didaktike shoqërohet me ikona që shënojnë aftësinë për të punuar në përputhje me nevojat e studentit në mënyrë që ai të mund të trajtojë lloje të ndryshme të fjalimit dhe leximit ndërsa përvetëson një shkallë të re të vetëdijës për gjuhën.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Studenti përdor formulat e zakonshme të mirësjelljes.
- Përfshihet në komunikime të shkurtra shoqërore.
- Diskuton në situata praktike të jetës së përditshme.
- Përshkruan, aktivitetet në të tashmen ose në të shkuarën, të cilat janë eksperiencat e tij

Objektivat specifike lëndore:

- Të ketë aftësi për të fituar koncepte bazë të gramatikës, të ortografisë, dhe fjalorit.
- Të ketë aftësi për të komunikuar me dialogje të thjeshtë.
- Të ketë aftësi për të krahasuar dhe nxitur arsyetimin logjik.
- Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
- Të ketë aftësi për të vlerësuar të tjerët dhe për t'u vetëvlerësuar.
- Të ketë aftësi për të konsultuar informacion në ëeb.
- Të ketë aftësi për të kuptuar tekste të shkruar dhe të gjejë informacion specifik, mbi të cilin është folur më parë.
- Të ketë aftësi për të shkruar tekste të shkurtër që kanë lidhje me të.
- Të ketë aftësi për të treguar thjeshtë, jetën personale të tij dhe të personave që e rrethojnë.